

VENDIM
Nr. 129, datë 7.4.2023

MBI KËRKESËN E SHOQATËS “AREA” PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË 16.2.2023, “MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI ME HYRJEN NË FUQI TË VKM-së NR. 67, DATË 8.2.2023”

(Ndryshuar me vendim nr. 302, datë 23.10.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.6.2016; neneve 67 dhe 91, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1199/2 prot., datë 5.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi kërkesën e shoqatës AREA “Për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023”,

konstatoi se:

- Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), me shkresën nr. 1810/176 prot., datë 24.2.2023, ka depozituar në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 27, datë 16.2.2023 dhe me shkresën nr. 1810 prot., datë 7.3.2023, ka plotësuar kërkesën fillestare të datës 24.2.2023 duke shtuar disa argumente në mbështetje të kërkesës së paraqitur më herët.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 16, pika 5 se çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Me shkresën nr. 930/5 prot., datë 13.3.2023, është vlerësuar e nevojshme qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me sa deklaruar nga shoqata AREA gjatë periudhës së diskutimeve, si dhe në lidhje me efektet juridike të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, së sipërcituar, përpara se ERE të shprehet mbi kërkesën e AREA-s për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 27/2023, për çka rezulton se aktualisht nuk ka një përgjigje nga ana e MIE-s.

- Në rrethanat e sipërcituara, vlerësojmë se ndodhemi përpara kushteve të nenit 66 pika 1 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se: “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

- Duke qenë se shoqata “AREA” legjitimohet si palë në këtë proces dhe ka paraqitur kërkesën brenda afateve ligjore të parashikuara, vlerësohet të pranohet shqyrtimi i kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27/2023.

- Për sa i përket objektit të shqyrtimit të kërkesës, vlerësojmë se duhet marrë në konsideratë edhe qëndrimin e institucioneve të tjera si MIE të përfshira në procesin e miratimit të aktit nënligjor VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, e për këtë qëllim ERE rezervon të drejtën të shprehet përfundimisht

me vendimmarrje për këtë kërkesë, pasi të ketë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet që lidhen me objektin e kërkesës për rishikim.

Për sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023”.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqatën “AREA” Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti